

1 E martë, 1 tetor 2024

2 [Konferencë mbi ecurinë e çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 14.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
7 Sekretare e seancës, paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
11 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Mirëdita dhe faleminderit që keni ardhur. Sot duam që t'u
15 kërkojmë palëve dhe pjesëmarrësve që të shprehim mendimet e
16 tyre sa i takon planifikimit dhe kalendarit për deri në fund
17 të vitit dhe në fillim të vitit tjetër, përderisa ne e kemi
18 bërë të ditur kalendarin deri në disa muaj në vitin tjetër.

19 Kam diçka për të thënë sa i takon kalendarit. Të hënën,
20 me datë 21 tetor, që është dita e parë pasi do të kemi një
21 pauzë në seancat gjyqësore, ne do të kemi një ndryshim të
22 kalendarit, do të kemi një ndryshim të orarit për atë ditë.
23 Atë ditë organizimi do të jetë i tillë: Do kemi seancë nga ora
24 2.00 [Sipas përkthimit] deri në orën 2.30 dhe pastaj do të
25 bëjmë një gjysmë ore pushim dhe pastaj do të kemi një seancë

1 tjetër për një orë e gjysmë nga ora 13 -- nga ora 3.00 deri në
2 orën 4.30.

3 Shkurtimisht dua që të jap statistikat e shkurtra. I kam
4 kontrolluar statistikat deri me datë 27. Ne kemi dëgjuar kaq
5 dëshmitarë për të gjithë procesin gjyqësor: Kemi dëgjuar 13
6 dëshmitarë të drejtpërdrejtë, 13 dëshmitarë sipas rregullës
7 75, pra, kemi 154 dëshmitarë, pastaj kemi 39 sipas rregullës
8 153, kemi 155 dëshmitarë sipas rregullës 32. Gjithsej kemi 159
9 dëshmitarë në të gjitha mënyrat e dhënies së dëshmisë deri me
10 datë 27 shtator.

11 Jemi informuar nga ZPS-ja që ajo planifikon që pjesën
12 tjetër të dëshmitarëve do ta thërrasë sipas planifikimit të
13 mëposhtëm: 15 dëshmitarë do të jenë drejtpërsëdrejti, do të
14 kemi 154 dëshmitarë sipas rregullës 50, 153 dëshmitarë sipas
15 rregullit 12, dhe 155 dëshmitarë sipas rregullit 14. Kjo do të
16 bëjë të mundur një periudhë prej gjashtë muajsh. Në fakt në
17 qoftë se do t'i marrim parasysh këtu edhe pushimin e Gjykatës.

18 Pra, kemi 24 ditë gjykimi nga tani deri në pushimin e
19 dimrit të Gjykatës, dhe 26 [Sipas përkthimit] gjykimi nga
20 janari deri më 15 prill që është përcaktuar data për
21 përfundimin e çështjes nga Prokuroria. Si rezultat kemi 60
22 ditë gjykimi maksimumi nga tani deri në datën që të përfundojë
23 parashtrimi i provave nga -- dhe i dëshmimeve nga ZPS-ja. Dhe e
24 kemi thënë disa herë, në fakt, këtë që dëshirojmë që të
25 përfundojmë me provat e Prokurorisë deri në mes të prillit. Ne

1 duam t'ju falënderojmë të gjithëve për përpjekjet tuaja.

2 Gjithsesi, sikurse e thashë dhe më përpara, jemi
3 kureshtarë edhe disi edhe skeptikë sa i takon faktit në qoftë
4 se provat e Prokurorisë dhe marrja kryesisht në pyetje e
5 dëshmitarëve do të mund të përfundojë siç është planifikuar
6 deri në mes të prillit. Ne kemi dëgjuar dëshmi për një vit e
7 gjysmë deri tani dhe kemi përfunduar 88 dëshmitarë që japin
8 dëshminë e tyre në Gjykatë.

9 Kështu që do të kërkoja që Prokurori të na thonë se çfarë
10 planifikon që të bëjë sa i takon pyetjeve të dëshmitarëve të
11 vet.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
13 Ne do të shkurtojmë numrat e dhënë, nuk do të thërrasim të
14 gjithë 65 dëshmitarët të cilët planifikohet që të vijnë dhe të
15 japin dëshmi *viva voce* sipas rregullit 154. Shkurtimisht, ne
16 nuk po planifikojmë që t'i thërresim të gjithë ata. Dhe
17 mendojmë që kjo do të jetë pjesë e zgjidhjes.

18 Ne kemi bërë të ditur gjithashtu dhe në planin tonë që
19 për faktorë të ndryshëm e kemi pasur të pamundur që gjithçka
20 ta kemi nën kontrollin. Megjithatë, siç kemi thënë edhe në
21 parashtrim e protokolluar në F02576/RED - lidhur me të
22 shkuarën dhe me përpjekjet për racionalizimin e çështjes, ne
23 po mundohemi gjithmonë e më tepër që të përmbushim datën e
24 synuar për përfundimin e provave nga Prokuroria.

25 Sfidat që kemi specifikuar në parashtrimin përkatës janë

1 të qenësishme. Këto i kemi parashtruar në çështjen
2 F02400/CONF/RED - dhe këto sfida vazhdojnë që të mbeten edhe
3 sot të qenësishme. Përfshirë këtu edhe mungesën e
4 bashkëpunimit dhe situatën të cilën janë -- e cila varion nga
5 një dëshmitar tek tjetri.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

9 [Përkthim] Ju lutem na thoni pak se çfarë keni
10 planifikuar.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ka dëshmitarë të cilët në qoftë se
12 do të vijnë këtu për dhënë dëshmi kundër vullnetit të tyre
13 mund të rrezikojnë që të kenë viktimizim dytësor si rezultat
14 i situatës dhe angazhimit të tyre të mëtejshëm si dëshmitarë,
15 dhe do të ishte shumë më mirë që të gjenim një zgjidhje tjetër
16 dhe të merrej parasysh gjithashtu edhe mirëqenia, dinjiteti i
17 dëshmitarëve, siç është rasti, për shembull, i Dëshmitarit
18 03978.

19 Megjithatë, është panevojshme të thuhet që kjo mund të
20 komplikojë thërritjen e dëshmitarëve dhe ne po vazhdojmë me
21 progresin, jemi të kënaqur me progresin e bërë dhe po bëjmë
22 punën tonë në përputhje me objektivat e përcaktuara nga Trupi
23 Gjykues dhe udhëzimet përkatëse.

24 Ne parashikojmë që thjeshtësimi i mëtejshëm të mund të
25 ndodhë, dhe deri me datën 1 nëntor 2024 do të japim numrin e

1 planifikuar si dhe racionalizimin e mëtejshëm të Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofon i çaktivizuar].

3 [Përkthim] Të personave që do të vijnë në Gjykatë?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po, të personave që do të vijnë në
5 Gjykatë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Nga 65 veta, të paktën shtatë,
8 megjithatë, do t'ju japim më shumë informacion kur të vijë
9 momenti përshtatshëm.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra ju
11 mendoni që është i arritshëm afati?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I kuptojmë
14 sfidat. Ne nuk -- ne i kuptojmë, ne i kuptojmë disa prej
15 sfidave dhe mund të zgjidhen në këtë sallë gjyqi. Do të
16 mundohemi dhe ne që të japim kontributin tonë për zgjidhjen e
17 komplikimeve.

18 Vërejtje që nuk parashikohet nga Trupi Gjykues që ne do ta
19 zgjasim ditën e synuar për përfundimin e provave nga
20 Prokuroria. Dhe përderisa ky është synimi ynë, mendojmë që do
21 të ishte me vlerë dhe e zgjuar nga ZPS-ja që të paraqesë
22 dëshmitarët më të rëndësishëm. Kështu që në qoftë se do të
23 ndodhë që të shkurtohet numri i dëshmitarëve në momentin e
24 fundit, do të ishte mirë që ato dëshmitarë që janë më pak të
25 rëndësishëm të jenë nga fundi, në mënyrë të tillë që të mos

1 humbni dëshmitarë të rëndësishëm.

2 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptojmë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht që
4 ju mund të komentoni në qoftë se doni që të komentoni
5 patjetër, ë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Po. E kuptojmë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një ndër
8 problemet që shkakton vonesë në pyetjet plotësuese të ekipeve
9 ka të bëjë me kohën e përcaktuar nga palët. E kemi parë
10 çështjen, megjithatë sa i takon Trupit Gjykues, ne jemi të
11 shqetësuar sa i takon shënimit të dytë që ka të bëjë me
12 informacionin e ri ose materialin e ri, dhe ky është shkak
13 kryesor për shqetësim për neve. Të paktën sipas -- nga ekipet
14 e Mbrojtjes.

15 Kështu që do të donim të dëgjonim lidhur me mënyrën e
16 seancave përgatitore, domethënë, që në seancën përgatitore të
17 mund -- dhe shënimet përkatëse të seancave përgatitore të mund
18 të dorëzohen më shpejt. Këtë e kemi diskutuar dhe më përpara.
19 Po ashtu ekzistojnë dhe të njëjtat probleme sa i takon -- sa i
20 takon pasjes së dëshmitarëve rezervë. Për shembull, javat --
21 dy javët e fundit janë një ilustrim shumë i mirë i kësaj
22 çështjeje, sepse në qoftë se do të kishit pasur dëshmitarë
23 rezervë, do të kishim përfunduar në Gjykatë të paktën dhe dy
24 dëshmitarë të tjerë.

25 Ne sigurisht që mund të gjejmë zgjidhje vetë si Trup

1 Gjykues, megjithatë do të vlerësonim shumë ose do të
2 preferonim që palët dhe pjesëmarrësit të mund të diskutojnë
3 ndërmjet tyre dhe të mund të zgjidhin problemet të tilla. Si
4 mund të shmangim harxhimin kot të kohës? Për shembull, thashë
5 ilustrimin e dy javëve të fundit, në qoftë se mund të keni
6 ndonjë përgjigje lidhur me këtë.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Për shembull, një çështje që doli,
8 nuk e di në qoftë se ka qenë dy javët e fundit apo jo,
9 megjithatë, me Dëshmitarin 02135 kjo është një ndër shkaqet
10 kryesore se pse nuk ka vijuar seanca ashtu siç ishte
11 planifikuar. Ka situata ku ne nuk parashikojmë dot se çfarë
12 mund të ndodhë.

13 Ka situata ku ne mund të thërrasim dëshmitarë më përpara.
14 Ne kemi thënë dhe kemi bërë që seancat përgatitore t'i bëjmë
15 gjithmonë e më tepër më përpara seancës gjyqësore sesa
16 mundemi. Megjithatë, në rastin në fjalë, dëshmitari ishte --
17 nuk ishte i disponueshëm. Pra, ai nevojitej të hënën, ndërkohë
18 seanca përgatitore ka përfunduar të enjten.

19 I mbajtem parasysh dhe i mbajtem shënim komentet e bëra
20 nga Trupi Gjykes, megjithatë do të mundohemi që të gjejmë
21 zgjedhjen e duhur.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni parasysh
23 që ka ngelur vetëm 60 ditë, kështu që çdo ditë është e vyer.
24 Kështu që duhet ta harxhoni çdo ditë sa më shumë të jetë e
25 mundur. Ta shfrytëzoni atë sa më shumë të jetë e mundur.

1 Ndërkohë, tani do të kemi disa pyetje që të kanë të bëjnë
2 me Mbrojtësin e Viktimave, po gjithashtu edhe me ekipet e
3 Mbrojtjeve. Megjithatë përpara sesa të vazhdoj me palët e
4 tjera do të doja t'i bëja, t'i drejtohesha kolegëve të mi për
5 të bërë pyetje për Prokurorinë në qoftë se do të kishin pyetje
6 të tilla.

7 Gjykatësi Barthe?

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
10 Mettraux.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, iu përgjigjët
12 pjesës më të madhe të pyetjeve. Megjithatë, kam edhe unë disa
13 pyetje të tjera plotësuese.

14 Nga parashtrimet tuaja unë kuptova që nuk është se do të
15 thërrisni 65 dëshmitarët *viva voce* ose dëshmitarë sipas
16 rregullës 154 dhe do të shkurtoni listën e këtyre
17 dëshmitarëve. E kuptojmë që nga 65, shtatë prej tyre do të
18 hiqen rreth nëntorit ose javës së parë të nëntorit. Po thjesht
19 do të pyesja në qoftë se kur do keni mundësi që të na
20 informoni plotësisht. Kur do të keni mundësi që të gjithë
21 palët, ekipet e Mbrojtjes të mund të njoftohen sepse ideja
22 është që palët nuk duhet që të harxhojnë kohë për dëshmitarë
23 të cilët nuk do të thërriten fare për të dhënë dëshmi në
24 sallën e gjyqit, kështu që njoftimi duhet të bëhet sa më
25 shpejt që të jetë e mundur.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Së pari dua të sqaroj afatin e
2 nëntorit, 1 nëntorit. Domethënë 1 nëntori është afati i fundit
3 për të dhënë informacion. Në qoftë se do e kishim këtë
4 informacion se kush do ishin këta dëshmitarë, shtatë
5 dëshmitarët që do të hiqen sot, do ta jepnin sot këtë
6 informacion.

7 Ndërkohë që më pas mund të parashikojmë një tjetër
8 racionalizim të çështjes, thjeshtësim të çështjes, deri në
9 pushimin e dimrit dhe pastaj pas pushimit të dimrit.
10 Domethënë, këto janë të gjitha vlerësimet graduale që ne i
11 bëjmë me kalimin e kohës dhe do të mundohemi që të japim
12 informacion në momentin kur të kemi më shumë hollësi lidhur me
13 situatën.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe disa çështje të
15 vogla. Për shembull, njëra prej këtyre çështje është se sa të
16 varur jeni nga dëshmitarët nga pikëpamja juaj, sa i takon
17 provave materiale të mbetura për t'u pranuar si prova prej
18 jush. A keni bërë një vlerësim të tillë? Domethënë, me fjalë
19 të tjera, a e keni ofruar pjesën dërmuese të materialeve
20 përmes parashtrimeve ose dokumenteve që do i paraqisni
21 drejtpërsëdrejti Trupit Gjykses apo do të mbështeteni tek
22 dëshmitarët për të kërkuar provueshmërinë e këtyre provave --
23 e këtyre materialeve si prova gjyqësore?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë kategori konkrete
25 të dokumenteve përveç atyre të cilat janë të lidhur me

1 dëshmitarët dhe që janë të dukshme, si të tilla si për
2 shembull, deklaratat e dëshmitarëve dhe provat materiale
3 shoqëruese dhe transkripteve. Sigurisht që ka dhe dokumente të
4 tjera të cilat mund të ofrohen për pranim drejtpërsëdrejti
5 përpara Trupit Gjykues.

6 Ne përgjithësisht, për shembull, kemi kërkuar përmes
7 mocionit që të pranoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga
8 Trupi Gjykues materiale që kishin të bënin me zonën
9 operacionale të Karadikut, në rastin e z. Russell që ishte
10 dëshmitar në gusht. Domethënë me fjalë të tjera po mundohem --
11 që ne i marrim këto vendime në mënyrë graduale në vartësi të
12 zhvillimeve të situatës.

13 Këto vendime në mënyrë të rregullt do t'i bëhen me dije
14 Trupit Gjykues.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon kategorisë ose
16 kategorive të dëshmitarë që juve planifikoni që thërrisni, ato
17 janë viktimat, domethënë, janë dëshmitarë viktimat në kategori
18 të gjëra? Persona të cilët kanë qenë të ndaluar në vende të
19 caktuara, të cilët nuk do jenë subjekt i dëshmisë së
20 dëshmitarëve ose kemi dëshmitarë të tjerë, të llojeve të
21 tjera, kështu që do ishte mirë që të na shpjegoni pak çfarë
22 lloj dëshmitarësh ju planifikoni të thërrisni për pjesën e
23 mbetur të kohës.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk mendoj se ka ndonjë tendencë
25 të përgjithshme ndërmjet viktimave dhe personave që kanë qenë

1 të brendshëm. Mendoj që pjesa më e madhe e tyre janë persona
2 që kanë vuajtur në qendra të ndryshme.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethënë është gjysëm për
4 gjysëm?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po, por numri viktimave,
6 domethënë, pjesa më e madhe e tyre është -- koha e tyre e
7 dhënies së dëshmisë në Gjykatë është shkurtuar, sepse kemi
8 kërkuar pranimin e deklaratave të tyre sipas parashtrimit 153.
9 Jemi munduar që të përcaktojnë përparësitë.

10 Kjo nuk është një gjë që mund ta bëjmë në çdo rast. Për
11 shembull, ka pasur raste që ne jemi përpjekur që të pranojmë
12 dëshmi, një dëshmitar sipas rregullës 153, sa i takon
13 dëshmitarëve të krimit, megjithatë, na është kërkuar që
14 dëshmia e tyre të mund të pranohej sipas rregullit 154. Ne po
15 përpiqemi që të bëjmë këtë lloj pune sipas parametrave të
16 përcaktuara nga Trupi Gjykues.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
19 Gaynor.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

21 Kam një pyetje që ka të bëjë me seancat përgatitore. Le
22 të themi, për shembull, rreth 60 dëshmitarë, sepse ju thatë që
23 do të ulni numrin e dëshmitarëve që mund të jenë rreth 60 ose
24 ndoshta 55, që do të jenë dëshmitarë *live* ose sipas rregullit
25 154, të cilët sërish do të duhet që t'i thërrisni këtu.

1 Mua më duket në qoftë se do të shikojmë listën e këtyre
2 dëshmitarëve, që të paktën disa prej tyre mund të jenë subjekt
3 i seancave përgatitore -- pra, ato mund të kalojnë seancat
4 përgatitore përmes videolidjes ose videolidhje përmes Zoom-it,
5 dhe pastaj ju mund të shkruani shënimet përgatitore numër 1
6 dhe 2, dhe këto shënime përgatitore t'ia jepni ekipeve të
7 Mbrojtjes paraprakisht përpara sesa ata atë mbërrijnë në Hagë.
8 Dhe më pas Mbrojtja ka kohë shtesë për të lexuar shënimet
9 përgatitore 1 dhe 2 dhe pastaj mund të përdorin përmbajtjet e
10 këtyre shënime me dëshmitarët dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve
11 [E padëgjueshme] që mund të kenë.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Ekziston mundësia që dhe në këtë
13 në fakt ne po mundohemi që të bëjmë. Po mundohemi që
14 dëshmitarë të caktuar të mund t'i pyesim nëpërmjet
15 videolidhjes. Pra kjo është diçka të cilën neve po e bëjmë
16 edhe për ata dëshmitarë për të cilët do të ishte e mundur që
17 historinë e tyre ta tregonin përmes videolidhjes, këtë histori
18 ta merrnim kështu dhe më pas të përgatisnim seancën
19 përgatitore dhe shënimet përkatëse të tyre, në mënyrë të tillë
20 që ekipet e Mbrojtjes të mund të përgatiten në kohën e duhur.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani kalojmë
22 tek Mbrojtja. E vlerësojmë faktin që ju keni bërë përpjekjet
23 tuaja. I kemi vënë re përpjekjet për të shkurtuar kohën e
24 pyetjeve të dëshmitarëve të Prokurorisë. Megjithatë, sikurse e
25 kam thënë në mënyrë të vazhdueshme, ne vazhdojmë që të kemi

1 probleme me kohën e zmadhuar, me vlerësimet e tejskajshme të
2 kohës që ju kërkoni për të marrë në pyetje dëshmitarët. Dhe ky
3 nuk është një problem i cili po del vetëm tani. Disa prej jush
4 e keni vlerësuar më shumë këto kërkesë që ju kemi bërë
5 gjithmonë përpara, por ndërkohë që ka ekipe, të cilat, sikurse
6 ndodhi dhe dje, vlerësimi për pyetjen e dëshmitarëve
7 fillimisht është tre orë dhe pastaj ajo çfarë ndodh është që
8 përdor vetëm gjysmë ore për pyetje.

9 Ju kemi kërcënuar më përpara që do të bëjmë, do të
10 përdorim praktikën e rishikimit të deklaratave të dëshmitarëve
11 dhe do të përcaktojmë kohë për ju dhe ju pastaj të përdorni
12 atë kohën që do të vlerësojmë neve. Ne nuk i kemi mohuar
13 asnjëherë kërkesën asnjë ekipi për të përdorur vlerësime të
14 kohës për përfunduar me pyetjet e dëshmitarëve të Prokurorisë
15 sipas nevojave dhe sipas kërkesave tuaja. Po unë nuk shikoj
16 asnjë arsye për të ndryshuar këtë praktikë dhe nuk mendoj që
17 kërkesat -- kërkesat kanë qenë të arsyeshme. Kështu që do të
18 na duhet që së pari juve të jepni një vlerësim të saktë të
19 kohës që do ju duhet, duke mbajtur parasysh që janë Trupi
20 Gjykues mundet në çdo kohë t'ju japë edhe kohë shtesë në qoftë
21 se përmbushen kërkesat përkatëse.

22 Tani dhe një herë do të doja që të vlerësonit në mënyrë
23 të arsyeshme se cila është koha që ju duhet juve dhe në mënyrë
24 që të na jepni një kohë më të arsyeshme.

25 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Tani besoj

1 se ju e keni vënë re që ne kryesisht i kemi qëndruar
2 parashikimeve kohore që kishim kërkuar, me ndonjë përjashtim
3 tek-tuk. Besoj se ka pasur raste për një ose dy dëshmitarë ku
4 kemi kërkuar për më shumë kohë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kjo pse
6 ngaqë s'ke qenë ti këtu ka ndodhur?

7 Z. MISETIC: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. I
8 përmirëson një çikë gjërat kur s'jam unë. Po dhe ne po
9 përpiqemi që të parashikimet kohore t'i kemi sa më të shkurtra
10 që të jetë e mundshme. Kemi thënë dy orë, një orë e gjysmë, me
11 përjashtim të rasteve kur gjykojmë që dëshmitari vërtetë është
12 shumë i rëndësishëm dhe duhet ta shtojmë kohën e
13 kundërpyetjeve.

14 Po do shtoja që kohët e fundit nuk kemi pasur fare
15 dëshmitarë rezervë gati. Unë nuk e di pse ka ndodhur kjo gjë.
16 Pra, nga gushti dhe deri në shtator nuk ka pasur asnjë
17 dëshmitar rezervë dhe mendoj që është mirë që ta prezantojmë
18 sërish këtë praktikën e dëshmitarëve rezervë kur kemi situata
19 të paparashikueshme.

20 Do të shihni që për bllokun e ardhshëm të dëshmitarëve ne
21 kohën që kemi kërkuar për kundërpyetjet e kemi të arsyeshme.
22 Edhe në shumë pak raste do të kërkohet një kohë e
23 konsiderueshme për kundërpyetjet.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
25 Dhe e kemi -- unë e thashë që në fillim, qysh në fillim ne e

1 kemi vënë re që të gjitha palët janë përpjekur -- jeni
2 përpjekur të mos përsërisni pyetjet, ndonëse dhe ka ndodhur me
3 raste të caktuara. Sidoqoftë ne e vlerësojmë.

4 Z. Dixon.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Edhe ne jemi përpjekur
6 që të sigurohemi t'u qëndrojmë afateve, parashikimeve kohore
7 që kishim kërkuar. Megjithatë ka dy aspekte që dua të trajtoj.
8 E para, njëherë, ka lidhje me seancat përgatitore. Fakti që i
9 marrim shënimet përgatitore në momentin e fundit, në vend që
10 ta jepni në një kohë të mjaftueshme paraprakisht. Nëse mund
11 t'i bëjmë këto seancat pak më herët në kohë, atëherë neve
12 marrim edhe shënimet në kohën e duhur, çka do të thotë që do
13 të kemi mundësi t'i shqyrtojmë dokumentet e reja, aspektet e
14 reja që kanë dalë në kohë të mjaftueshëm paraprakisht, dhe më
15 pas të jemi të përgatitur për kundërpyetjet tona, të bazuar në
16 materialet që gjenden në shënimet përgatitore. Duhet ta
17 kuptoni që në qoftë se vjen shënimi përgatitor dy ditë para,
18 na duhet kohë që t'i shqyrtojmë të gjitha materialet. Edhe
19 vetëm në momentin e fundit pasi i kemi kaluar të gjitha
20 materialet, mund të japim ne një parashikim kohor të saktë.

21 Pra, edhe një herë, nëse bëhet seanca përgatitore më
22 herët, parimisht do të na ndihmonte të gjithëve ne që të japim
23 kohën e duhur që na nevojitet për kundërpyetjet. Dhe sigurisht
24 që ne të gjithë synojmë që të -- t'i qëndrojmë afatit të
25 prillit, prandaj duhet të bashkëpunojmë të gjitha palët që të

1 realizojmë këtë qëllim.

2 Gjithashtu, a mund të na thonë Prokuroria paraprakisht
3 ne, se cilat pjesë, për shembull, të Shënim Përgatitor 2, në
4 veçanti, synojnë ta trajtojnë edhe me dëshmitarin
5 paraprakisht. Sepse shpesh ndodh që ka 20 pika në Shënimin
6 Përgatitor 2, por me pyet -- gjatë pyetjeve Prokuroria trajton
7 një ose dy paragrafë vetë, ç'ka do të thotë ne i marrim një
8 për një të gjitha pikat, përgatitemi, por ama me trajtohet
9 vetëm një ose dy pika. E kam vënë re që kanë ndodhur kohët e
10 fundit veçanërisht kjo. Duhet të keni parasysh që kjo është
11 shumë e rëndësishme për ne që të përgatisim kohën tonë.

12 Do ishte e dobishme për ne sikur Prokuroria të thoshte
13 sikur dhe 20 orë përpara, për shembull, që "shiko ne vetëm
14 pikën një dhe pesë do të trajtojmë tek Shënimin Përgatitor 2".
15 Kjo të na ndihmonte shumë. Sigurisht që duket situata të
16 jashtëzakonshme. Ne të gjitha këto i pranojmë. Por kjo do na
17 ndihmonte që të shkurtonim numrin dëshmitarëve.

18 Gjithashtu dua të theksoj dhe një herë pse nuk ka
19 dëshmitarë rezervë, zëvendësues. Sikur një dhe dy, tre. Pse
20 nuk ka 2-3 gati, që të jenë gati, t'i sjellim për seancë
21 momentin e fundit, siç ishte edhe rasti i kësaj jave. Për
22 shembull, në qoftë se s'do kemi seancë të enjten, të kemi një
23 dëshmitar rezervë edhe sikur të jetë dëshmitar më me pak
24 rëndësi, që të mos të çojmë kohën e vyer dëm.

25 Theksoj edhe një herë, pra, që është dobishme që të kemi

1 gati dëshmitarë rezervë, sepse ditët janë të caktuara këtu në
2 Gjykatës. Ka edhe aspekte të paparashikuara që duhen marrë
3 parasysh, por kur ka dalë kalendari, afërmendsh duhet të jenë
4 gati dhe dëshmitarët edhe të jenë të përgatitur çfarë të
5 ndodhi në një skenar B.

6 Prandaj duhet të ketë, pra, nga ana e Gjykatës një
7 parashikim më të mirë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të keni
9 parasysh që dhe dëshmitarët kanë një jetë, ë. Duhet të
10 përshtatemi me jetën e tyre. Nuk mund të na përgjigjen kur
11 dëshirojmë ne. A mund të na thoni diçka z. Halling lidhur me
12 dëshmitarët dhe disponueshmërinë e tyre, pse nuk i keni dy apo
13 tre gati?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Edhe ne duam që të kemi
15 dëshmitarë rezervë. Kemi pasur 2 dëshmitarë rezervë ne sipas
16 rregullës 154 që e kemi parashtruar në numrin F02593.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur mund të
18 jenë gati?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Për dëshmitarët rezervë janë gati
20 për bllokun e radhës, çka do të thotë që do të jenë gati të
21 vijjnë momentin e fundit nëse lind nevoja midis datës 21 nëntor
22 dhe 7 -- 21 tetor dhe 7 nëntor.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
24 do jenë gati që të nesërmen?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Tani unë mund t'ju thoja që do

1 jetë gati për të nesërmen, po ideja është që dëshmitarët
2 rezervë duhet të jenë gati në momentin e fundit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari
4 dje bëri një deklaratë në fund që kishte shtatë ditë që rrinte
5 këtu. Edhe është pak shqetësuese kjo. Nuk mund ta lëmë një
6 person të rrijë ka gjatë në një qytet të huaj, vetëm, për të
7 ardhur këtu për të dhënë dëshmi. Merrini parasysh edhe këto
8 situatat.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Unë po mendoja sidomos për
10 dëshmitarët me videolidhje. Mbase këta dëshmitarë mund të
11 pyeten në një afat më të shkurtër.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë keni
13 të drejtë. Të shfrytëzojmë rastet me videolidhje për
14 dëshmitarët e momentit të fundit. Është më e lehtë për ata,
15 është më e lehtë për ne.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Vetëm që të njoftojmë paraprakisht
17 në mënyrë që të përgatitemi dhe ne dhe të mos e marrim vesh
18 momentin e fundit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë shkurtimisht në fakt do flas.
21 Unë sot i thashë vetes -- unë sot i premtova vetes time që nuk
22 do i drejtoj askujt gishtin për vonesat.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky është
24 veprim i mençur.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po ideja është që ne po bëjmë të

1 pamundurën që të japim parashikime kohore realiste. Megjithatë
2 edhe unë jam përgjegjës ndonjëherë. Ka ndodhur ndonjëherë që
3 kemi thënë që duhet një konsiderueshme dhe e kemi rivlerësuar
4 pasi e kemi dëgjuar dëshmitarin dhe kemi vendosur që, në fakt,
5 duhet të shkurtojmë kundërpyetjet dhe ndonjëherë të mos bëjmë
6 pyetje fare. Po kjo është pjesë e një procesi gjyqësor.

7 Ne kemi të drejtën të bëjmë atë që është -- që besojmë që
8 është në interesin e klientit tonë, e rrjedhimisht që nëse ne
9 njoftohemi ne paraprakisht për dëshmitarin ne mund të japim
10 dhe parashikimin më realist. Në qoftë se ka ndryshime të mëdha
11 është e pamundur dhe për ne.

12 Po siç ju thashë kjo është pjesë e procesit. E ky është
13 realiteti i proceseve gjyqësore, këto gjëra ndodhin që siç dhe
14 ju e dini shumë mirë në fakt.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
16 z. Roberts.

17 Një çast ju lutem.

18 Mesatarisht sa kohë kërkohet nga momenti i mbylljes së
19 seancës përgatitore deri në dorëzimin e shënimeve përgatitore
20 tek pjesëmarrësit?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse thoni fundi seancës është
22 momenti që i lexojmë edhe një herë dëshmitarit shënimin
23 përgatitor, unë mund të them që është -- kjo ndodh brenda të
24 njëjtës ditë, pra - brenda të njëjtës ditë. Ne ua çojmë me
25 email, po ja çojmë edhe përmes paketës së materialeve që

1 nxirren sipas rregullave

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Ellis, fjala është për ju

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani shumica e pikave janë ngritur

5 dhe më përpara. Ne po përpigemi të jemi sa më të saktë në

6 parashikime tona kohore. E vlerësoj që ndonjëherë Trupi

7 Gjykues na ka dhënë dhe kohën që na është dashur pak më tepër

8 ose ne me ekipet me njëri-tjetrin i marrim kohë njëri-tjetrit

9 për të bërë pyetjet përkatëse.

10 Po kohët e fundit, për shembull, ka qenë një rast me

11 Dëshmitarin 4752, ku ne e reduktuam kohën që kishim kërkuar

12 fillimisht, por megjithatë gjatë kundërpvetjeve lindi prapë

13 nevoja që të kërkonim kohë shtesë, sepse ne ishim përpjekur që

14 të jepnim një kohë sa më të shkurtër por, situata ndryshoi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjëherë

16 varet çfarë pyetjesh bëni, varet nga pyetjet tuaja.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Sigurisht nuk dua të hy në debate të

18 këtij lloji po është një situatë që ka qenë kohët e fundit.

19 Edhe theksoj edhe një herë atë që sapo u tha për seancat

20 përgatitore, është Shënimi Përgatitor 2 ai që është

21 veçanërisht me interes, sepse dalin dokumente të reja të cilat

22 do duhet t'i shikojmë dhe ne një herë nga e para, edhe më pas

23 nuk përdoren fare nga Prokuroria gjatë pyetjeve të veta. Dhe

24 ne ndërkohë punojmë shumë me dokumente që nuk dalin fare, nuk

25 trajtohen fare.

1 Duhet të keni parasysh që ne përpiqemi të jemi sa më
2 efektivë me kohën tonë. Nëse pyetjet tona janë bërë nga ekipet
3 e tjera ne atëherë i përshtasim pyetjet sipas rastit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
5 Gjykatësi Barthe më duket se kishte një pyetje.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësit
7 Smith, dhe mirëdita të gjithëve.

8 Kam një a dy pyetje për ekipet e Mbrojtjes. Pyetjet e mia
9 nuk janë në lidhje me kohën që kërkonti ju për kundërpvetjet
10 dhe përgatitjen për dëshmitarët, por parashtrimet tuaja sipas
11 rregullës 130.

12 Duke parë gjithmonë drejt së ardhmes, siç e dini, në bazë
13 të kësaj rregulle, menjëherë pas mbylljes së provave nga ana e
14 Prokurorisë, Mbrojtja do të bëjë njoftimin lidhur me synimin
15 që ka për të kërkuar rrëzimin e akuzave në aktakuzë. Ky mocion
16 dorëzohet brenda 10 ditësh pasi mbyll Prokuroria provat e
17 veta, dhe Prokuroria kundërpërgjigjet pastaj brenda 10 ditësh
18 pas marrjes së mocionit.

19 Pyetja ime e parë është për Mbrojtjen. Prezumojmë që ju
20 do kërkonti të dorëzoni mocion sipas kësaj rregulle. Nuk më
21 intereson nëse do ta dorëzoni apo jo mocionin. Po dua të di
22 këtë: A mund të na jepni një parashikim nëse 10 ditëshi, afati
23 10 ditor është i mjaftueshëm që ju të dorëzoni mocionin? Dhe
24 në qoftë se nuk është i mjaftueshëm mocioni -- afati, më
25 falni, 10 ditor, mund të na thoni sa kohë do ju duhet?

1 Sigurisht nuk është diçka detyruese, ë. Po kjo do na ndihmojë
2 ne të bëjmë pastaj planifikimin kohor nga prilli 2025 e në
3 vijim.

4 Kush prej ekipeve dëshiron ta marrë fjalën?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Pyetja ishte e drejtpërdrejtë dhe
6 unë do jap një pyetje të drejt -- përgjigje të drejtpërdrejtë.
7 Jo, nuk mendoj që mjaftojnë dhjetë ditë, duke marrë parasysh
8 përmasat që ka kjo çështja gjyqësore, numrin e dëshmitarëve,
9 kohën që është dashur. Ne do kërkojmë të paktën një muaj.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Parashtrime të tjera prej palëve?

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Tani nuk mund t'ju themi, është
13 diçka që do ta shqyrtojmë dhe do vendosim kur të mbarojë
14 Prokuroria. Por, i qëndroi asaj që tha kolegu im, z. Ellis, që
15 do na duhet më shumë kohë duke marrë parasysh çështjen
16 gjyqësore.

17 Një nga aspektet që do ishte me interes për mua për të
18 vendosur nëse do ta dorëzojmë mocionin apo jo, është
19 interpretimi që do i bëjë Trupi Gjykues rregullës 130 dhe nëse
20 mund të përjashtojnë disa incidente faktike, apo nëse do
21 përjashtohen dëshmi të plota.

22 E kam parë me interes këtë. Ka pasur dallime opinionesh
23 në të shkuarën lidhur me këtë, po mua kjo do më interesojë se
24 pastaj do të vendos unë nëse do dorëzoj një mocion të tillë
25 dhe më pas mund t'ju them unë sa kohë do të më nevojitet mua

1 për ta dorëzuar mocionin.

2 Këto po i them kështu çfarë më vjen në mendje tani, sepse
3 do më duhet të shikoja me vëmendje atë formulimin e rregullës
4 130.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne bëmë fiks
6 të njëjtën gjë sot.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dixon.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse ushtrojmë këtë të drejtë,
10 njësoj si kolegët mendoj që do kërkojmë kohë shtesë, duke
11 marrë parasysh kompleksitetin e kësaj çështje. Po kjo lidhet
12 dhe me një pyetje tjetër se nuk dua tani të flas tani për
13 provat e Mbrojtjes. Po do ishte mirë që të dimë dhe sa kohë do
14 t'i lejohet Mbrojtjes për të paraqitur provat e veta në mënyrë
15 që të përgatitem paraprakisht.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne do ju
17 pyesnim ju sa kohë doni. Kjo është pyetja më e duhur.

18 Z. DIXON: [Përkthim] E prita këtë pyetje. Në fakt është
19 rëndësishme që të konsultohemi, të marrim udhëzime, por kjo do
20 jetë një aspekt shumë i rëndësishëm që të kuptojmë ne kur do
21 mbarojë Prokuroria fillimisht me provat e veta, që në fakt [E
22 padëgjueshme] që në fakt doli e saj, po pastaj të planifikojmë
23 ne kohën tonë sepse ne kemi bërë hetime sigurisht gjatë kohës
24 që Prokuroria ka bërë pyetjet e veta, por nuk kanë qenë të
25 mjaftueshme për shkak dhe ngarkesës së kësaj çështje

1 gjyqësore. Kemi pasur kufizimet tona.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në fakt unë kisha një pyetje
3 për z. Dixon.

4 Në fakt për ne është e rëndësishme t'ju themi që ne na
5 intereson të dimë se si do jetë e ardhmja pasi të mbarojë
6 Prokuroria me provat e veta. Nëse ju vendosni të dorëzoni
7 mocionin sipas rregullës 130, pastaj do të duhet të shqyrtojmë
